

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Hysnije Gashi, anëtar si dhe me bashkëpunëtorin profesional Alban Beqiri, në lëndën penale kundër të akuzuarit H.M., për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrant nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda PPI.nr.228/2014 të datës 15.01.2015, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shukri Jashari, të akuzuarit H.M. dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.D.R., pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datë 27.04.2015 dhe 30.04.2015 dhe të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli kurse me datë 04.05.2015, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H.M., nga i ati Sh. dhe e ëma F. e gjinisë I., data e lindjes.... në Han të Elezit, me vendbanim në të njëjtin vend rr.”.....” pn, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar babë i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i padënuar, i identifikuar me numër personal nr.....

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 31.10.2014, rreth orës 20:30, në pikën kufitare Hani Elezit, me qëllim të për F.B. të dobisë pasurore, ka kontrabanduar qytetar të republikës së Kosovës, me qëllim që ti dërgoj në Shtetin e Francës, pa i plotësuar kushtet për qëndrim të ligjshëm në këtë shtet, në atë mënyrë që i pandehuri me veturën e tij Golf V, i ka marrë viktimat në Prishtinë nga një person me emrin I., i cili kishte marr 8,000€ nga A.I. për ta dërguar në Francë me bashkëshorten e tij I.I. dhe fëmijët D. dhe A., kurse nga viktimat F.B. kishte marr 3.000€, të cilët i pandehuri i kishte sjell deri në pikën kufitare Hani Elezit, nga vetura e tij kishin zbritur A.I. së bashku me bashkëshorten dhe dy fëmijët,

kurse i pandehuri kishte kërkuar nga një taksist tjetër që ta dërgoj vetëm I.I. deri në stacionin e autobusëve në Shkup për të cilin shërbim e kishte paguar në shumë prej 16€, kurse të dëmtuarin F.B. e kishte transportuar deri në dalje të pikës kufitare të Republikës së Maqedonisë, ndalet skaj rrugës për të pritur A.I. me fëmijët D. dhe A., të cilët me ndihmën e një personi të panjohur kishin kaluar kufirin në mënyrë ilegale pastaj për të vazhduar rrugën për në destinacion të caktuar me ç'rast ndalet nga policia maqedonase dhe i njëjti dorëzohet tek autoritete policore të republikës së Kosovës dhe arrestohet.

- me të cilën ka kryer veprën penale kontrabandimi me migrant nga neni 170 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 170 par.1 lidhur me nenin 31 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 31, 42, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPP-ës, e

G J Y K O N

ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 6 /gjashtë/ muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, kurse në dënimin e shqiptuar do ti llogarite koha e kaluar në paraburgim nga data 31.10.2014 deri më datën 16.12.2014 dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 16.12.2014 deri më datën 30.04.2015 ,

DHE ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 500 (pesëqind) €, i cili dënim do ta paguaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë revokohet dhe nuk mund të ekzekutohet në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuajnë një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 /njëqind/ €, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Të dëmtuarit F.B., A.I. dhe I.I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën të evidentuar si PPI.228/2014, të datës 15.01.2015, ka akuzuar H.M., për veprën penale kontrabandimi me migrant nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 27 prill 2015, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza.

I akuzuari në fillim të shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë duke e shprehur pendim real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, kurse në fjalën e tij përfundimtare ka propozuar Gjykatës që ti shqiptoj dënim sa më të butë si dhe duke premtuar se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.D.R., në fjalën përfundimtare ka propozuar Gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh se i akuzuari në mënyrë të sinqertë ka bërë pranimin e fajësisë duke shprehur pendim dhe njëkohësisht duke premtuar se nuk do të përsërisë vepra penale të kësaj natyre, e që me rastin e shqiptimit të dënimit Gjykata të merr parasyshë rrethanat personale të të akuzuarit se është prind i tre fëmijëve, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe që sipas këtyre rrethanave të i shqiptoj një dënim nën minimumin e përcaktuar ligjor.

Po ashtu edhe Prokurori i Shtetit Shukri Jashari, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili pranim është në përputhje të plot me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës është e pritshme që ndaj të akuzuarit edhe me aplikimin e dispozitës së nenit 75 par.1 nënpar. 1.3 të KPRK, mund të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.D.R., pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat

e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht dëshmitë e dëshmitarëve F.B., A.I., I.I. dhe S.L. të dhënë në procedurën hetimore, fotografive që gjenden në shkresat e lëndës, videoinqizimi dhe ekspertiza të laboratorit të forenzikës të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale kontrabandimi me migran nga neni 170 par.1 lidhur me par.31 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuarin me dashje direkte ka kontrabanduar qytetar të Republikës së Kosovës me qëllim që ti dërgonte në shtetin e Francës, në atë mënyrë që i pandehuri me veturën e tij Golf V nga stacioni i autobusëve në Prishtinë me sugjerimet e një personi me emrin I. ka marr viktimat F.B. A.I. dhe I.I. sëbashku me dy fëmijët e tyre D. dhe A. dhe i ka dërguar deri te kufiri në Han të Elezit ku në mënyrë ilegale e ka kaluar kufirin dhe pastaj janë arrestuar nga ana e policisë maqedonase dhe të njëjti i kanë kthyer mbrapa tek zyrtarët policor në Hanë të Elezit dhe janë arrestuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në në kuptim të nenit 73 të KPK-ës dhe atë si rrethanë veçanarisht lehtësuese mori, pranimin e fajësisë, si dhe në rolin e tij dytësor në këtë vepër penale pasi që tërë planifikimin dhe realizimin e veprës penale e kishte bërë personi me emrin I. e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat lehtësuese se i pandehuri shprehu pendim të thellë dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, pastaj rrethanat e tij personale se më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, se është i martuar prind i tre fëmijëve ndërsa nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me aplikimin e institutit të zbutjes së dënimit, në kuptim të nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, edhe me anë të këtij dënimi (nën minimumin e përcaktuar ligjor) është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, duke u nisur nga fakti se i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat e kryerjes, se edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e

veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale Preventiva gjeneralë).

Konform nenit 463 par.2 të KPP-së, Gjykata ka udhëzuar të dëmtuarit F.B., A.I. dhe I.I., që realizimin e kërkesës pasurore –juridike mund ta realizojnë në kontest civil, meqë nga të dhënat e siguruar gjatë procedurës penale nuk japin të dhëna të plota e as të pjesërishme për të vendosur lidhur me këto kërkesa.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 /njëqind/€, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurit, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA, PKR.nr. 7/2015, me datën 04.05.2015.**

I.

**Bashkëpunëtori profesional,
Alban Beqiri**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.